



V E N D I M
K.P.P. 385/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Ligus” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-50092-02-22-2018, me objekt: “Blerje Ekskavator”, me fond limit 3,750,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.03.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Memaliaj.

Ankimues:

“Power Industries” shpk
Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, qendra “Alpas”, hyrja nr. 2, kati nr. 5, ap nr. 14, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Memaliaj
Adresa: Rruga “Tafil Buzi”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.02.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-50092-02-22-2018, me objekt: “Blerje Ekskavator”, me fond limit 3,750,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.03.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Memaliaj.

II.2. Në datën 05.03.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 09.03.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Gajd Company” shpk	Pa dokumenta	skualifikuar
- “Ligus” shpk	2,979,000	kualifikuar
- “Power Industries” shpk	3,680,000	kualifikuar

II.4. Në datën 09.03.2018, operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 16.03.2018 operatori ekonomik “Power Industries” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ligus” shpk, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

Së pari: Në datë 05.03.2018 kemi marrë pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Ak Bashkia Memaliaj me objekt “Blerje Ekskavator”, dhe fond limit 3,750,000 lek pa tvsh, në datë 09.03.2018 jemi njohur me klasifikimin si më poshtë:

1- “Ligus” shpk	2,979,000	JO
2- “Power Industries” shpk	3,680,000	JO

Në si shoqëri jëmi prekur / dëmtuar nga vendimi i autoritetit kontraktor i marrë në kundërshtim me LPP deh dokumentat e tenderit të përcaktuara nga vetë autoriteti, po ju parashtrajmë kundërshtimet tona në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ligus” shpk, në këtë procedurë. Në nënin 46 të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret”, pra detyra e KVO-së është që të bëjë kontrollin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik për procedurën që prokurohet në mënyrë që të konstatojë plotësimin dhe përputhjen e dokumentave të paraqitura me kërkesat e vendosura nga AK në DST, si kusht për kualifikimin e operatorëve. Legjislatori e ka lënë në dorë, nën përgjegjësin e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e kontratës përcaktimin e kriterëve të veçanta për kualifikim. Pra nga sa më sipër AK për sa kohë që ka përcaktuar kriterë të veçanta për këtë procedurë, kriteretë cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për verifikimin e gjëndjes ekonomike, financiare, teknike dhe ligjore të operatorëve ekonomik atëherë edhe në klasifikimin e operatorëve ekonomik duhet ti mbajë parasysh këto kërkesa të përcaktuara prej tij. Nëse kualifikimi i OE do të bëhet në varësi të rastit apo dashamirsisë së AK atëherë është e kotë që autoriteti të caktojë kriterë në DST për kualifikimin e O, pasi nëse marrim rastin më të keq ndonjë prej atyre kriterëve mund të jetë bërë shkak edhe për mospjesmarrjen e ndonjë operatori tjetër i cili i ka verifikuar dhe ka konstatuar që nuk i plotëson kushtet për të marrë pjesë. Nga informacionet që shoqëria jonë ka në bazë të kërkimeve onlinë, dokumentave të publikuara, bazuar edhe në procedurat e mëparshme në të cilat kjo shoqëri ka marrë pjesë, ju parashtrajmë disa prej pikave të DST për të cilat kemi bindjen e plotë që shoqëria “Ligus” shpk nuk i ka plotësuar.

Së dyti: Subjekti ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik të mjetit, ku te jetë përcaktuar lloji i automjetit që ofron dhe elementët teknike që e shoqërojnë atë.

Së treti: Certifikatë PAS – 99 – 2012 të vlefshme.

Për kërkesat e mësipërme të përcaktuara nga autoriteti juaj në DST për të cilat shoqëritë në momentin që kanë marrë pjesë kanë rënë dakort për plotësimin e tyre, shoqëria “Ligus” shpk

ka mungesë fizike të këtij dokumentacioni: Certifikata PASS 99:2012 nuk është paraqitur pasi kjo shoqëri nuk e disponon këtë certifikatë, pra nuk është e certifikuar me PASS 99:2012.

Katalogu i paraqitur nga kjo shoqëri është i paplotë dhe me mungesa të cilat e pengojnë autoritetin tuaj për të verifikuar plotësimin e kushteve teknike të mjetit të kërkuar dhe i papërkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe sipas kërkesës suaj në pikën 4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X, te Dst. Autoriteti juaj në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në DST ku përcaktohet që: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti ose dokumentave të rremë e të pasaktë, konsiderohen si kushtu për skualifikim, e ka kualifikuar këtë operator ekonomik në kundërshtim me DST dhe LPP duke diskriminuar shoqërinë tonë e cila i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret e vendosura nga ju.

Për arsyet e përcaktuara më sipër kërkojmë nga autoriteti juaj skualifikimin e operatorit ekonomik “Ligus” shpk, pasi nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim dhe është kualifikuar në mënyrë të padrejtë, arbitrare dhe në kundërshtim te plotë me DST, LPP dhe shpalljen fitues të shoqërisë “Poëer Industries” shpk për këtë procedurë.

II.4.2. Në datën 21.03.2018, me shkresën nr. 341/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Power Industries” shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor.

II.4.3. Në datën 03.04.2018 operatori ekonomik ankimues “Power Industries” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresave me nr. 442/3 prot., datë 10.04.2018 protokolluar me tonën me numër 670/2 prot., datë 11.04.2018, dhe shkresës me nr. 442/3 prot, datë 10.04.2018 protokolluar me tonën me numër 670/3 prot., datë 13.04.2018, me objekt “Dërgim Informacioni” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Power Industries” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Ligus” shpk, me arsyetimin se: “[...] shoqëria “Ligus” shpk ka mungesë fizike të këtij dokumentacioni: Certifikata PASS 99:2012 nuk është paraqitur pasi kjo shoqëri nuk e disponon këtë certifikatë, pra nuk është e certifikuar me PASS 99:2012 [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 8/2 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar:

“[...]Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në zotërim të certifikatë [...]”

- Certifikatë PASS 99 : 2012 të vlefshme.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “Ligus” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë”;
- ISO 27001:2013 “Çertifikatë për sistemet e sigurisë”;
- ISO 14001:2004 “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit”;
- ISO 18001:2007 “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë”;
- ISO 28000:2007 “Çertifikatë specifike për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit”;
- SSH ISO/IEC 17021:2011 Certifikatë Akreditimi, “Çertifikim i sistemeve të menaxhimit për kodet EA 16, EA 17, EA 28, EA 29, EA 35”;

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.1.5. Neni 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.

III.1.6. Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje

me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e këtij të fundit.

III.1.7. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Ligus” shpk, rezulton se ka paraqitur dokumentat; **1- ISO 9001:2015 “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë”;** **2- ISO 27001:2013 “Çertifikatë për sistemet e sigurisë”;** **3- ISO 14001:2004 “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit”;** **4- ISO 18001:2007 “Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë”;** **5- ISO 28000:2007 “Çertifikatë specifike për sistemin e menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit”;** **6- SSH ISO/IEC 17021:2011 Certifikatë Akreditimi, “Certifikim i sistemeve të menaxhimit për kodet EA 16, EA 17, EA 28, EA 29, EA 35”;**; referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik “Ligus” shpk, rezulton se ky operator ekonomik nuk ka paraqitur “*Certifikatë PASS 99 : 2012*”, për plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.11. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Ligus” shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit, pasi kërkesa për “*Certifikatë PASS 99:2012*” nuk është dorëzuar nga operatori ekonomik “Ligus” shpk, duke mos plotësuar në këtë mënyrë kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Ligus" shpk., në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i operatori ekonomik ankimues "Power Industries" shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Power Industries" sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë "Ligus" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.9., gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "Ligus" sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Power Industries" shpk për procedurën e prokurimit "Kërkesë për Propozim" me Nr. REF-50092-02-22-2018, me objekt: "Blerje Ekskavator", me fond limit 3,750,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 05.03.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Memaliaj
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik "Ligus" shpk dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryer.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik "Power Industries" shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr.670 Protokoli, Datë 03.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha